

Në SUOGJ “Koço Gliozheni” funksionon vendimarrja sipas normave të përcaktuara në rregullore, konkretisht:

Komisioni Mjekësor i Spitalit

Komisioni Mjekësor ka 11 anëtarë dhe është organ këshillimi teknik i drejtorisë që ngrihet dhe funksionon sipas Statutit të Spitalit.

Komisioni Mjekësor konsulton lidhur me aspektet mjekësore të punës, me përshkrimin e detyrave sipas funksioneve dhe organizimin e shërbimeve mjekësore;

Komisioni Mjekësor konsulton për projektet dhe politikat e zhvillimit të spitalit, jep mendim për mbylljen, modifikimin apo krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për vendosjen e tarifave mjekësore;

Komisioni Mjekësor thirret në mbledhje nga Drejtori i Përgjithshëm. Në mbledhjet e tij, lidhur me problematika të veçanta, mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë nga personeli i Institucionit.

Komisione të tjera

Përveç Komisionit Mjekësor të Spitalit të përcaktuar në Statutin e SUOGj “Koço Gliozheni”, funksionojnë edhe:

- Komisionet *ad-hoc* të disiplinës;
- Komiteti i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore.

Komisionet e disiplinës (*ad-hoc*)

Në raste shkeljesh të ankesave për shkelje të legjislacionit, rregulloreve, etikës dhe kontratës së punës nga punonjës të ndryshëm, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SUOGj “Koço Gliozheni” për shqyrtimin e çështjes përkatëse ngrihen Komisionet *ad-hoc* të Disiplinës, të cilat kanë për objekt realizimin e procedurave dhe verifikimin e provave të çështjes, me qëllim garantimin e respektimit e rregullit të procesit të rregullt.

Komisionet e Disiplinës ndjekin hapat e procedurës disiplinore, që fillon nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni me shkrim, të personit që cilit i atribuohet shkelja, deri në aritjen e një vendimi përfundimtar për rastin.

Komisionet e Disiplinës, merren me shqyrtimin e ankesave/raportimeve vetëm në rastet kur informacioni i marrë rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, Komisionet e Disiplinës bëjnë klasifikimin e shkeljeve bazuar në Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës dhe legjislacionin në fuqi.

Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, Komisionet e Disiplinës fillojnë ecurinë disiplinore dhe njoftojnë, me shkrim, punonjësin përkatës:

- a. për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;
- b. për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c. për të drejtën që ka për t'u njohur me provat, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;

Komisionet e Disiplinës si organe disiplinore, hetojnë të gjitha faktet dhe vlerësojnë të gjitha rrethanat e ngjarjes, që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorin çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe kryejnë përveç të tjerash por jo vetëm, veprimet e mëposhtme:

- a. pyesin ose marrin deklaratë nga dëshmitarët dhe verifikojnë faktet kundërshtuese;
- b. rishikojnë dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për faktet që mungojnë, etj.;
- c. thërrasin personin për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjeve apo të problemit;
- d. verifikojnë praktikën dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
- e. kryejnë çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.
- f. Vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore merret në rastet kur:
- g. nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;
- h. rezulton se punonjësi nuk ka kryer shkelje me faj;
- i. veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga punonjësi përkatës.

Komisionet Disiplinore paraqesin pranë Drejtorit të Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të punëdhënësit relacionin përfundimtar dhe sugjerimin për vendimin lidhur me dhënien e masës disiplinore.

Komisionet e disiplinës përbëhen nga të paktën:

- a. eprori direkt i punonjësit objekt procedimi;
- b. një jurist i Institucionit dhe
- c. njëri nga Zv/drejtorët e Spitalit – për punonjësit e administratës dhe shërbimeve mbështetëse Zv/drejtori ekonomik, ndërsa në rastin e personelit mjekësor dhe teknik mjekësor Zv/drejtori teknik.

Komisioni i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore

Komisioni i kontrollit të infeksioneve spitalore realizon trajnime për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore me qëllim zvogëlimin e riskut të transferimit të infeksioneve midis pacientëve, personelit mjekësor dhe stafit mbështetës.

Përbërja dhe funksionimi i komisionit caktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, bazuar në propozimin e Zëvendës drejtorit Teknik dhe Kryemamisë së Përgjithshme.